



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë
Mbledhja nr. 16
Prishtinë, më 27.7.2021, në orën 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Pacolli-Dalipi, Milazim Salijaj, Ekrem Mustafa, Arbëreshë Kryeziu- Hyseni, Salih Zyba, Samra Ilijazi, Albena Reshitaj dhe Fadil Nura.

Munguan: Zoran Mojsilović, Bekim Haxhiu dhe Besian Mustafa.

Pjesëmarrës të tjerë: Këshilltarët: Labinot Smakaj dhe Muhamet Bytyçi; Valbona Puka dhe pjesëmarrës tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi, **Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e Komisionit.**

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar më 19.7.2021,
3. Shqyrtimi i Projektligjit në parim nr. 08/L-027 për Mbeturinat nga industrinë nxjerrëse të mineraleve;
4. Shqyrtimi i Projektligjit në parim nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e ajrit nga ndotja;
5. Propozimet dhe përzgjedhja e ekspertëve për mbikëqyrjet e ligjeve në grupet e formuara punuese;
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua duke plotësuar me pikën shtesë për fatkeqësinë në komunikacion në Kroaci.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 19.7.2021

Komisioni e miratoi procesverbalin pa asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim.

1. Fatkeqësia në komunikacion në Kroaci

Kryetarja këtë pikë shtesë që votoi komisioni për rendin e ditës, filloi me ngushllime për familjarët dhe potencoi këtë tragjedi në komunikacion si vetdijsim si për institucione dhe më gjërë. Meqenëse ky komision përfshinë infrastrukturën dhe transportin rrugor, ajo sugjeroi në emër të komisionit që pas analizave apo rishikimeve të duhura, të dërgohen rekomandimet e duhura nga ky komision, prandaj hapi diskutimin.

Milazim Salijaj ishte i mendimit që ky komision gjithsesi duhet të reagojë, fillimisht me ndonjë vizitë në kompanitë përkatëse transportuese.

Albena Reshitaj e cilësoi këtë aksident komunikacioni si ngjarje të rëndë, e cila të gjithëve duhet të na vetëdijësoi duke potencuar se është fat që ka ndodhur në Kroaci, përndryshe po të ndodhte në rrugët tona numri i viktimave do të dyfishohej. Vlen të potencohet dhe të falenderohet Kroacia si shtet, tha ajo, sepse ka reaguar menjëherë dhe me urgjencë, me të gjitha mundësitë që ka pasur. Fatkeqësisht, vazhdoi, neve na mungon një emergjencë i tillë, ndaj urgjent duhet të analizohet kjo situatë në përgjithësi në çdo aspekt dhe sa më afër familjrëve tani të jemi, pastaj të ulemi të diskutojmë se çfarë mund të veprojme duke propozuar ndryshim plotësimet në legjislacion, por edhe gjetiu.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni u bashkëngjiti ngushllimeve për këtë rast tragjik duke propozuar që të rekomandohen veprimet e duhura për rishikimin e ligjeve infrastrukturore nga ky komision por edhe të vizitohen kompanitë që kanë obligime transportuese. Shërbimet shëndetsore ka qenë dashtë të bëhen me kohë sepse askush nuk mund të parashehë kur mund të ndodhin këto fatkeqësi.

Salih Zyba u pajtua se një veprim i ngutshëm nga ky komision është i domosdoshëm, por sgjeroi në Ministrinë përkatëse, përmes përfaqësuesit të këtij komisioni, me çka u pajtua edhe **Ekrem Mustafa** ngase një grup nga ky komision që do të vizitonte ministrinë, do të vepronte si një presion për syqeltësi sidomos për mjetet transportuese ku në të ardhme duhet të saktësohen çështjet rreth vozitësve të transportimit etj. Apeloj të mos ngutemi të flasim apo nxjerrim konkludime ngase mund të lëndohen familjarët.

Fadil Nura propozoi koordinimin e këtij komisioni me ekzekutivin për avansimin e legjislacionit me prioritete për ndryshime dhe plotësime në legjislacion, në mënyrë që mos të ndodhin këto aksidente në të ardhmen.

Kryetarja falënderoi për kontributin për këtë pikë ndërkaq në diskutime e sipër komisioni u dakordua të vizitonte MMPHI të enjten 29.7.2021 duke u nisur nga kuvendi në orën 8.30, paraprakisht të lajmrohen deputetët te stafi se kush dëshiron të jetë pjesë e vizitës.

2. Shqyrtimi i Projektligjit në parim nr.08/L-027 për mbeturinat nga industrinë nxjerrëse të mineraleve

Kryetarja e paraqiti për shqyrtim në parim Projektligjin nr.08/L-027 për mbeturinat nga industrinë nxjerrëse të mineraleve dhe tha se ky ligj ka për qëllim të përcaktojë masat, procedurat dhe udhëzimet për të parandaluar ose zvogëluar sa më shumë që të jetë e mundur efektet negative në mjedis, veçanërisht në ujë, ajër, tokë, florë, faunë dhe peizazh, si dhe çdo rrezik që rezulton për shëndetin e njeriut si rezultat i menaxhimit të mbeturinave nga industrinë nxjerrëse. Projektligji për Mbeturinat nga industrinë nxjerrëse të mineraleve është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2006/21 / EC, të Parlamentit Evropian mbi administrimin e mbetjeve nga industrinë nxjerrëse, që ndryshon Direktiven 2004/35 / EC. Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave vlerëson se Projektligji nuk do të krijojë kosto shtesë buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës. Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe propozoi që t'i rekomandohet Kuvendit për miratim në parim.

Lidhur me këtë projektligj kërkoi fjalën **Fadil Nura** lidhur me disa mangësi në këtë projekt rreth përgjegjësi të komunave, por edhe me dispozitat ndëshkimore në të, ku parashihet

kompetencë e gjërë për inspektorin, megjithatë ai shprehu gatishmërinë që në procedurat e mëtejme të japë kontributin.

Kryetarja, pastaj ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se komisioni, unanimitisht vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji nr.08/L-027 për mbeturinat nga industrinë nxjerrëse të mineraleve

3. Shqyrtimi i Projektligjit në parim nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e ajrit nga ndotja

Kryetarja, e paraqiti për shqyrtim në parim Projektligjin nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e ajrit nga ndotja, dhe tha se ky ligj ka për qëllim të përcaktojë kompetencat institucionale dhe përgjegjësitë për mbrojtjen e ajrit, shtresës së ozonit, zvogëlimin e nivelit të gazrave serrë, përshtatjen dhe zbutjen ndaj ndryshimeve klimatike, monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së ajrit, masat për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes së ajrit, raportimin për cilësinë e ajrit, shkëmbimin e informatave, veprimtaritë e monitorimit të emisioneve në ajër dhe substancave që e dëmtojnë shtresën e ozonit, sistemin informativ të ajrit, me qëllim që të rregullojë dhe të sigurojë të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit nga ndotja e ajrit. Dispozitat e projektligjit nuk i cenojnë parimet bazë të legjislacionit të BE-se dhe është pjesërisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e financave vlerëson se Projektligji nuk do të krijojë kosto shtesë buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës. Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe propozoi që t'ia rekomandohet Kuvendit për miratim në parim.

Po ashtu edhe për këtë projektligj, **Albena Reshitaj dhe Arbëreshë Kryeziu-Hyseni** diskutuan në aspektin e rëndësisë që ka ky ligj si pjesë e legjislacionit evropian.

Salih Zyba insistoi që për këto ligje në mes të dy leximeve të ketë debate dhe dëgjime publike.

Albena Reshitaj ndërhyri dhe sqaroi se duhet të zgjerohet përgjegjësia sepse prekin shumë interesa: nëse dikush shumë vite ka punuar gabim nuk do të thotë se ne nuk duhet të përmirësojmë përgjegjësitë, tha ajo.

Kryetarja theksoi se mu për këtë arsye i ka radhitur këto dy projektligje në mbledhjen e sotme për të pasur më vonë kohë më tepër për shqyrtime dhe debate ndaj premtosi se jo vetëm një debat por do të organizohen shqyrtime derisa të shqyrtohen projektligjet në mënyrën e duhur deri në leximin e dytë, sidomos sa i përket PL për ajrin i cili i takon dhe i nevojitet secilit në Kosovë, jo vetëm partive apo pozitës ose opozitës.

Pastaj ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se komisioni, unanimitisht vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji nr. 08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

4. Propozimet dhe përzgjedhja e ekspertëve për mbikëqyrjen e ligjeve

Kryetarja potencoi se në një nga mbledhjet e kaluara komisioni vendosi formimin e 4 grupeve të punës për mbikëqyrjen e ligjeve, si dhe janë caktuar kryesuesit dhe anëtarët e tyre, si vijon:

Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës, në këtë përbërje: Salih Zyba, kryesues, Fadil Nura, Ekrem Mustafa, Samra Ilijazi dhe Fitore Pacolli-Dalipi – anëtarë;

Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, në këtë përbërje: Albena Reshitaj, kryesuese, Milazim Salijaj dhe Fitore Pacolli-Dalipi – anëtarë;

Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-114 për pasurimin e miellit, në këtë përbërje: Besian Mustafa, kryesues, Bekim Haxhiu dhe Fitore Pacolli-Dalipi – anëtarë;

Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2003/5 për farërat, në këtë përbërje: Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, kryesuese dhe Salih Zyba – anëtar.

Ndërsa në lidhje me angazhimin e eksperteve është kërkuar që të sjellin edhe propozimet, që do t' i ndihmojnë grupet punuese dhe komisionit në këtë proces dhe pastaj të votohen në komision. Nga deputetët janë paraqitur 4 propozime për ekspertë:

Mufail Salihaj, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për pasurimin e miellit;

Sami Kryeziu, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për farërat;

Azdren Doli, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për pyjet dhe

Avdi Gjonbalaj, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ujërat.

Komisioni në fund votoi në parim për zgjedhjen e tyre, por duhet që të shikohen konfliktet e mundshme të interesit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Fitore Pacolli-Dalipi,

Kryetare e Komisionit